



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/115

Datë: 09.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 102.1 dhe 103.1 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Revokohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/18 i datës 11 mars 2015 për themelimin e Komisionit për hartimin e draftit të Kodit Civil.
2. Kompetencat e Komisionit sipas vendimit të revokuar me pikën 1. të këtij vendimi, përkatësisht hartimin e draftit të Kodit Civil, i barten Ministrisë së Drejtësisë.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFÄ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë